THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI

Qendra ALERT, në kuadër të zbatimit të projektit "Rinia Aktive për Politika të Qëndrueshme", të *mbështetjur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, (MSHRF)*, shpall thirrjen e interesit për realizimin e 6 (gjashtë) podcasteve, me kriteret e mëposhtme:

Podkastet duhet të jenë minimumi 30 minuta deri në 40 minuta
Të regjistrohen në formatin 4K
Të kenë elementët e një studioje televizive përsa i përket anës teknike dhe vizive

Kërkesat tjera që duhet të përmbushë podcast:

Të improvizohet studio në ambientet e zyrave te Qendrës ALERT ose të jetë studio e gatshme për intervista teke, moderatori plus një i ftuar
Cilësia kamerave dhe e pamjeve filmike 4K
Cilësia e zërit, maksimale
Kompania prodhuese do të duhet të ketë të gjitha pajisjet, regji, kamera, mikrofona, ndriçim dhe të gjithë anën teknike për realizimin e tyre.
Të ofrojë montazhin e të gjitha bisedave (podcast), rregullimin grafik dhe vendosjen/montazhin e logove dhe Disclaimers, deri në dorëzimin final te porositësi.

Kriterët për kualifikimin e ofruesve të shërbimit

Ofruesit të shërbimit i kërkohet të ketë:
Të paktën minimumi 1 vit përvojë pune në realizimin dhe mirëmbajtjen e produksioneve të tilla ose të ngjashme, evente, aktivitete, podcaste etj.
Kapacitete dhe infrastrukturë teknike për të siguruar prodhim me cilësi të lartë.

Afati kohor i realizimit të produkteve.

Një në muaj (gjashtë muaj në total)

Pronësia inteletuale
Të gjitha informacionet në lidhje me këtë produkt do të mbeten pronë e Qendrës ALERT, Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Detyrimet kontraktuale
Shërbimi do të kontraktohet sipas kushteve të kontratës së Qendrës ALERT dhe do të mbikëqyret po nga ALERT, për të ofruar rezultatet e mësipërme brenda kornizës kohore të rënë dakord.

Procedura e Aplikimit

Qendra ALERT
Adresa: Rr.Fadil Rada, P. 9/1, Shk. 1, Ap. 4, Tiranë, Shqipëri
E-Mail: info@alert.al - granitsokolaj@alert.al
Tel: +355 69 40 08 008 - +355 69 30 28 258
Web: Alert.al

Aplikantëve u kërkohet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme në e-mailin **info@alert.al**, jo më vonë se data 18 gusht 2025, ora 17.00.

Dokumentacioni i kërkuar nga aplikantët:

CV (portofol punësh) të kompanisë që do të ofrojë shërbimin
Propozimi financiar për kryerjen e shërbimit/produktit;
Kontaktet (telefon, e-mail dhe adresë);

Tiranë, më 05.08.2025

Qendra ALERT
Adresa: Rr.Fadil Rada, P. 9/1, Shk. 1, Ap. 4, Tiranë, Shqipëri
E-Mail: info@alert.al - granitsokolaj@alert.al
Tel: +355 69 40 08 008 - +355 69 30 28 258
Web: Alert.al